



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr 06-15122 /2022

Klinë, 12,05, 2022

PROCESVERBAL

I mbledhjes së tretë të Kuvendit të Komunës të Klinës në vitin 2022, mbajtur më 25. 03. 2022, filluar në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi i cili përshëndeti gjithë anëtarët e Kuvendit dhe në emrin e anëtarëve të Kuvendit përshëndeti kryetarin e Komunës, nënkyetaren, drejtorët e drejtorive, përfaqësuesin e OSBE, Mediat dhe gjithë të tjërët e pranishëm në sallë.

Kryesuesi shpalli të hapura punimet e seancës dhe konstatoi se prezent në sallë janë 27 anëtarë. Ai në vazhdim duke theksuar se sot është ditë zie e shpallur nga presidentja e vendit në nderim të jetës së ish sekretares së shtetit mik të Amerikës, Medeline Albrighte, kërkoi që me një minutë heshtje të nderohet kujtimi për të edhe nga anëtarët dhe të pranishmit në sallë.

Para se të fillonin me rendin e ditës, kryesuesi i Kuvendit kërkoi nga anëtarët e Kuvendit të cilët nuk e kanë plotësuar akoma formularin e deklarimit të pasurisë ta bëjnë atë sa më shpejt të jetë e mundur. Kërkoi që njoftimin se e keni deklaruar pasurinë ta dorëzoni tek zyrtari në drejtorinë e arsimit, tek Elbarim Morina. Gjithashtu kryesuesi tha se dua që ta bisedoj pak çështjen e furnizimin me llaptopo. Ai theksoi se s'ka rrugë tjetër përvëç se të kthehen llaptopët nga ata që nuk janë më anëtarë të Kuvendit. Ndërsa ata që janë nga mandati i kaluar mund të vazhdojnë të i shfrytëzojnë llaptopët e marruar nga mandati i kaluar ndërkohë për anëtarët e rinj do të fillon procedura përfurnizim. Të gjithë ata nga mandati i kaluar që llaptopat e marruar i kanë jashtë funksionimit të i sjellin dhe të futen në listën përfurnizim me llaptop të rinj. Gjithashtu për rendin e ditës e kam një kërkesë e cila ka të bëjë për ndarjen e mjeteve përfurnizim e festivalit folklorik "I këndojmë Lirisë".

Për Rendin e ditës fjalën e morën anëtarët e Kuvendit.

z. Esat Raci: Përshëndetje të nderuar. Kryesues siç jeni në dijeni me kërkesën tonë nga seanca e parë e këtij legjislacioni përfshirë furnizim me material- dokumente. Keni kërkuar nga ne që këtë ta bëjmë me shkrim e që ne edhe e kemi bërë me datë 10.02. 2022. Duke ju drejtuar kryetarit të Komunës. Po e lexoj kërkesën: Ne si grup i asamblistëve të PDK-së kërkojmë që të na sjellët materiali fizik më së largu deri në seancën e marsit përfshirë datën nga 01. 09. 2021 deri me 31. 12. 2021 duke përfshirë, koston e tyre, afatin dinamik si dhe komisionet mbikëqyrëse përfshirë këto projekte. Deri me sot nuk kemi marrë asnjë material fizik apo material tjetër. Sot, në ulësen time e gjejë një letër ku shkruan projektet e realizuara 2021, pa kosto të tyre pa komisionet mbikëqyrëse. Prandaj të nderuar, duke e parë këtë injorancë dhe mos përgjigje korrekte ndaj kërkesës së përfaqësuesve të qytetarëve, ne shenjë pakënaqësie ne nuk do të marrim pjesë në punimet e kësaj seance. Dua të ju drejtohem dhe të jua bëjë me dije që në seancat e ardhshme do të bëjmë prap kërkesë më shkrim përfshirë informimet përfshirë punësimet në administratë dhe arsim në këtë tre mujorin e parë të këtij viti. Sikurse edhe përfshirë shpenzimet përfshirë dreka e darka gjatë kësaj periudhë. Ju faleminderit.

Grupi i PDK-së e braktisin sallën e mbledhjes.

z. Zafer Gashi: Përshëndetje përfshirë. Na intereson cila do të jetë pika e radhës në rendin e ditës, kjo e festivalit. Arsyja është sepse edhe ne kemi bërë disa kërkesa me shkrim drejtuar disa drejtorëve përfshirë informuar dhe pajisur me disa dokumente. Me datë 04. 03. 2022 ju kam drejtuar drejtorit të arsimit me një kërkesë përfshirë furnizim me listën e mësimdhënësve në shkollën e mesme "Fehmi Agani" përfshirë kohore Janar 2021 deri me 15 shkurt 2022, nuk kam marrë asnjë përgjigje. Gjithashtu ju kam drejtuar me shkrim drejtorit të Urbanizmit përfshirë lejen e dhënë përfshirë ndërtimin e fabrikës së çimentos por nuk më është përgjigjur. Drejtorit të Shëndetësisë gjithashtu por që zotëri Bacaj më është përgjigjur dhe e falënderoj shumë. Edhe drejtorit e Administratës, z. Binak Sylaj e falënderoj shumë përfshirë përgjigjen korrekte të dhënë. Ligji përfshirë vetëqeverisje lokale na jep neve si asamblistë të kemi casje në çdo kohë në dokumente zyrtare, prandaj edhe ne si grup kuvendar sot ën shenjë pakënaqësie përfshirë mos dhëni e dokumenteve dhe mos përgjigjen në kërkesat tona, largohemi nga kjo seancë por do të kthehemë në pikën e rendit të ditës ku do të votohet buxheti përfshirë festivalin e Mujë Krasniqi.

z. Arben Limanaj: Përshëndetje. Besoj që ekzekutivi duhet ta marr më shumë seriozitet këtë pjesën e largimit të grupeve opozitore dhe të jetë më korrekt në detyrën që e ka. Unë me këto pak seanca që kemi mbajtur kam parë jo gatishmëri të drejtoria e arsimit. Ne si opozitë jemi që të përmirësohet qeverisa e pozitës. Tani sa kam marr informacion se është marr në një pozitë një zyrtar në drejtorinë e arsimit dhe është kërkuar një zyrtar specialist i shkencave shoqërore ndërsa është pranuar zyrtar i shkencave natyrore, kjo bije në kundërshtim me atë që është kërkuar në konkurs. Morra vetëm një shembull konkret, kështu si kjo besoj që janë shumica e konkurseve. Dua të

them që të jeni më korrekt ndaj kërkesave të opozitës dhe anëtarëve të Kuvendit që mos të ndodhë që opozita ta braktisë mbledhjen.

z. Valmir Bacaj: Përshëndetje të gjithëve. Ne si grup Kuvendar i AAK-së, kërkojmë që ashtu sikurse ka listë të nënshkrimit të anëtarëve në fillim të seancës të ketë listë nënshkrimesh edhe në përfundim të seancës sepse nuk mendoj që është korrekte që të nënshkruhen anëtarët në fillim vetëm sa për mëditje dhe më pastaj ta braktisin seancën.

z. Zenun Elezaj, Kryetar i Komunës: Përshëndetje për të gjithë anëtarët e Kuvendit. Unë nuk dua të merrem me arsyet që ata i kanë. Dua të ju informoj se për të gjitha kërkesat e bëra nga grupet në fjalë të opozitës ne ju kemi ofruar material më bollëk dhe ju jemi përgjigjur. Sot grupi kuvendar i PDK-së e ka marr kopjen fizike me të gjitha projektet e realizuara gjatë tërë vitit. Edhe LVV dua të ju them se çdo anëtarë i kuvendit ka të drejt të merr dokumentet e kërkuar porse duhet të ju drejtohen zyrtarëve adekuat dhe brenda 7 ditëve jemi të obliguar që të ju përgjigjem. PDK e ka pasur një kërkesë dhe përgjigja ju është dhënë sot. Nëse përgjigja ka pasur mangësi ajo do të ishte plotësuar gjithsesi por LVV çdo ditë ka bërë kërkesa dhe ka marruar përgjigje. Bazuar në ligjin në fuqi për dhënien e dokumenteve zyrtare të kërkuar ne jemi të obliguar që ta bëjmë.

z. Fadil Gashi, kryesues: Duhet parë mundësitet e bashkëpunimit mes vete pa ja cenuar të drejtën asnjërit. Besoj që edhe ata që braktisen sallën edhe këta që kanë mbetur në mbledhje ma merr mendja që jemi në shërbim të qytetarëve. Dikush del e dikush rrinë, ky është sharmi i demokracisë. Në parim e kam e këtë e dinë të gjithë ata me të cilët kam punuar, prej seancës së parë pas luftës, kemi qenë korrekt dhe thënë të drejtën gjatë gjithë kësaj kohe vetëm një herë kemi braktisë mbledhjen. Ne edhe në seancën e kaluar kemi shpenzuar goxha shumë kohë duke jua sqaruar grüp të LVV-së se kërkesat që i dërgojnë nëpër drejtori, ne si kuvend nuk kemi njojuri dhe nuk është e drejt me na ra në qafe neve derisa nuk kemi informacionin që ata kanë bërë kërkesa të tillë. Kërkesat e tyre direkte nëpër drejtori i nënshtronë ligjit për casje në dokumente zyrtare si gjithë të tjérët. Mënyrën e kundërshtimeve unë jam që ta zhvillojmë këtu në sallë e mos të braktisen salla. Kush ka diçka tjetër për rend dite le të urdhëron.

Kryesuesi e vuri në votim Rendin e Ditës me propozimet që ai i bëri në fillim të kësaj seance dhe me 17 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika 1 e Rendit të Ditës: Kryesuesi theksoi se në hapje të seancës kanë qenë të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe do të vazhdoj sipas listës së nënshkruar për këtë pikë të rendit të ditës.

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Pa asnjë vërejtje procesi u MIRATUA me 17 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Pika 3 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i rekomandimeve të KPF-së.

Kryesuesi theksoi se një pjesë e rekomandimeve janë në rend të ditës dhe shpreson që ka vullnet që të kalohen por paraprakisht foli për kërkesat.

Kërkesa e parë është e parashtrua nga shkolla fillore në Sferkë- Bartja e nxënësve. Ne si KPF jemi dakorduar që kjo kërkesë të shkoj në drejtorinë përkatëse.

Shefat e grupeve kuvendare, z. Valmir Bacaj dhe Arben Limanaj kërkuant që rekomandimet të shkojnë në votim në pakos. Z. Limanaj, kërkoj që në lidhje me kërkesën për transportin e nxënësve të krijuhet një komision paraprak në kuadër të DKA-së ose Kuvendit që do të bëjë vlerësimin e kërkesave për transportin e nxënësve ashtu siç ka qenë dikur një komision i tillë.

z. Tunë Dedaj: Përrshëndetje për të gjithë. Edhe unë jam dakord me propozimin e z. Limanaj për themelimin e komisionit të tillë.

Kryesuesi kërkoj që të propozohen tre anëtarë për këtë komision. Pas propozimit të z. Arben Limanaj që në këtë komision të jenë tre anëtarë nga tre partitë opozitare dhe dy nga pozita, u pajtuan të gjithë.

U Propozuan: Luigj Ademi, Arlinda Selitaj, Blerina Gashi, LVV, PDK

Këto propozime u vendosën në votim dhe me 17 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Pas kësaj kryesuesi i vendosi në votim rekomandimet në pakos të KPF-së dhe me 17 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUAN.

Pika 4 e Rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i shpalljes së propozim listës së pronave komunale të Komunës së Klinës.

Kryesuesi theksoi se listën e kanë marrur anëtarët e Kuvendit dhe se bëhet fjalë vetëm për shpallje të kësaj liste e jo për shitje të pronave. Kryesuesi ofroi mundësinë që të prezantohet kjo listë nëse dikush nga ekzekutivi dëshiron.

z. Zenun Elezaj, Kryetar: Ekzekutivi për çdo vit në fund të vitit e propozon në Kuvend listën e pronave komunale për shfrytëzim. Këtë vit e kam parë të rëndësishme që ta hartojmë një listë të pronave dhe më pastaj sipas procedurave dhe udhëzimeve ligjore do të shpallim procedurat tenderuese për marrjen në shfrytëzim të pronave.

Kryesuesi e vuri në votim shpalljen e kësaj liste dhe me 17 vota për, asnjë kundër asnjë abstenim u MIRATUA.

Pika 5 e Rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi për vënien në diskutim publik të programit tre vjeçar për banim.

Kryesuesi theksoi se pas diskutimit publik për këtë program , ai do të vije prap në Kuvend për shqyrtim dhe votim.

Me 17 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 6 e Rendit të Ditës: Propozim vendimi për themelimin e këshillit Komunal për siguri në bashkësi.

Pas sqarimit paraprak të kryesuesit në lidhje me këtë propozim vendim , u vendos në votim dhe me 17 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika 7 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i planit të veprimit të shërbimit të ekosistemit dhe investimet inteligjente në Komunën e Klinës.

Kryesuesi theksoi se kjo është debatuar edhe në mandatin e kaluar. Kemi pasur dëgjim publik për këtë çështje. Është plan që përfshin edhe një komunë të Shqipërisë. Ai tha se materialin e keni marrur dhe për vazhdimësinë e procedurave mund të informohemi edhe në planin që e keni amrrur. U vendos në votim dhe me 17 vota Për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 8 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe Miratimi i propozim Vendimit për shpalljen e konkursit për zgjedhjen anëtarëve të dy Komiteteve konsultative dhe themelimin e panelit interviewues.

Kryesuesi Gashi fillimisht e vuri në votim propozimin për themelimin e dy komiteteve në fjalë , Komiteti për çështje emergjente dhe Komiteti për zhvillim rural...dhe me 17 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA themelimi i tyre

Për themelimin e panelit interviewues çelësi është 5 anëtarë. U propozuan:

1. Shemsedin Berisha, 2. Enver Gashi, 3. Binak Sylaj, 4. OJQ, 5. PDK

Me 17 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 9 e Rendit të Ditës: Ndarja e mjeteve për festivalin folklorik “ I këndojmë lirisë”

Kryesuesi theksoi se janë 20 mijë euro që duhet të ndahen për organizmin dhe mbajtjen e festivalit. Në vazhdim kërkoj që të deklarohen me vota anëtarët e Kuvendit për këtë ndarje. Me 17 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika 10 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe Përgjigje

Znj. Blerina Gashi: Përshëndetje. Kam një pyetje për drejtorinë e urbanizmit. Në fshatin Qupevë e lartë janë 7-të shtëpi që përballen me problemin e ujërave të zeza. Të gjitha këto ujëra të zeza derdhen në një gropë që është hapur vet nga banorët e fshatit e që kjo gropë paraqet një rrezikshmëri të lartë për fëmijët që jetojnë në këtë fshat. Dua të dijë nëse është në projekt për këtë vit zgjidhja e këtij problemi.

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizmit: Përshëndetje për të gjithë. Sa i përket kanalizimit të ujërave të zeza të shtëpive që janë përballë rrugës në lagjen Binakaj e dimë që është shumë e nevojshme të investohet në kanalizim por në këtë fazë nuk

kemi projekt tē caktuar. Me rishikimin e buxhetit nē muajin qershor do tē mundohemi qē ta bëjmë shtrirjen e kanalizimit nē këtë pjesë tē fshatit dhe bëjmë zgjidhje pēr atë problem.

Znj. Marigona Raci: Pērshëndetje pēr tē gjithë. Edhe unë kam një pyetje pēr drejtorin e Urbanizmit. Siç e dini nē fshatin Siqevë ka qenë nē projekt kyçja nē kanalizim i tërë fshatit. Më saktësisht nga fillimi i rrugës "Fehmi Lladroci" , duke përfshirë rrugën " Vesel Mehmeti" ka mbetur pa kyçje nē kanalizim. Është një rrugë qē ka shumë qarkullim tē nxënësve. A mund tē na jepni përgjigje se kur do tē filloj projekti pēr kyçje nē kanalizim tē kësaj pjese?

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizmit: Muajin e ardhshëm mendojmë qē tē fillojmë procedurat pēr këtë çështje nē fshatin Siqevë.

z. Enver Gashi: Pērshëndetje. Pyetja e jonë është pēr drejtorin e Shërbimeve Publike. A keni paraparë apo hartuar ndonjë plan operativ pēr qentë endacak?

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Pērshëndetje kryetar, prof., dr. Zenun Elezaj dhe gjithë tē pranishmit. Z. Gashi, Komuna e Klinës e ka një kontratë dy vjeçare 2021-2022 pēr trajtimin e geneve endacak. Kemi filluar qē nga java e kaluar sipas rekomandimeve tē veterinarëve. Një rast e kemi pasur nē fshatin Sferkë ku kemi intervnuar. Problemi i geneve endacak është mjaft i madh dhe trajtimi i tyre nga ordinanca bëhet pēr një periudhë 7 ditore ku më pastaj lirohet sepse rrezikshmëria e tyre zvogëlohet pēr 70-80% . Po ashtu ne nuk kemi buxhet tē madh qē tē vazhdojmë ti mbajmë tē izoluar më tej. Qē nga java e ardhshme kudo qē tē ketë nevojë , nē çdo fshat tē Komunës së Klinës, jemi nē gjendje qē tē intervenojmë.

z. Tunë Dedaj: Pyetjen qē doja ta bëja unë e bëri Enver Gashi. Në fakt kam dy pyetje dhe po e bëjë opozitën nē këtë rast pasi qē opozita mungon nē sallë. Qentë endacak janë shqetësim pēr gjithë qytetarët dhe unë nuk e shoh si zgjidhje tē këtij problemi marrjen e geneve, trajtimin e tyre dhe lirim i tyre përsëri. Askush nuk po jua ndalon këtyre geneve qē tē sulmojnë fëmijën, plakun etj. Po ashtu dëme tē konsiderueshme do tē bëjnë edhe nē kulturat bujqësore sepse është një numër i madh i geneve endacak. Është mirë qē tē angazhohet qeveria qē tē bëjë një zgjidhje pēr këtë problematikë. Po e shfrytëzoj rastin qē tē shprehë para drejtorit tē urbanizmit një shqetësim tē qytetarëve tē Jagodës. Kanalizimi i ujërave tē zeza është dëmtuar nē këtë fshat dhe pasi qē është edhe një vit qē projekti ka sigurimin nga kompania, kërkoi nga drejtori qē tē angazhohet dhe zgjidhet ky problem.

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizmit: Po e vërtetë qē ekziston ai problem [por asnjë projekt pa u bërë pranimi teknik nuk quhet i përfunduar. Prandaj ne do tē kërkojmë nga operatori ekonomik qē ta bëjë rregullimin e kësaj.

Znj. Marigona Raci: Kam nj pyetje pēr drejtorin e Shërbimeve Publike. Pasi qē një fshat ka ndriçim publik pse mos ta ketë edhe fshati tjetër. P.sh. Fshati Siqevë nuk ka fare ndriçim publik. Çfarë kriteri duhet tē plotësoj fshati qē tē ketë ndriçim publik.

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Nuk ka ndonjë kriter. Në dy vitet e ardhshme do të përfundoj shtrirja e rrjetit të ndriçimit publik në të gjitha fshatrat e Klinës. Për momentin veç e kemi përfunduar në fshatin Ujmir. Pastaj do të vazhdojmë me Shtaricë, Siqevë etj.

z. Zef Nrecaj: Kam një pyetje për drejtorin e Urbanizmit. Është një urë në fshatin Ranocv afér varrezave që ka nisur të ndërtohet që në vitin 2017 por që ka mbetë e pa përfunduar. I vetmi intervenim ka qenë në vitin 2021 gjatë fushatës zgjedhore që është shtruar pak zhavorr në të. Kjo urë nuk ka as sinjalizues dhe e bënë të rrezikshme kalimin mbi të natën. Ka shqetësimë të mëdha nga qytetarët e kësaj pjese dhe ju intereson ta dinë se kur do të përfundoj kjo urë.

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizmit: Për këtë pyetje përgjigjëm në mbledhjen e radhës pasi që më duhet të i shqyrtoj të gjitha të dhënat e projektit.

Pas pyetjes së fundit, kryesuesi Gashi duke i falënderuar të gjithë të pranishmit por edhe grupet që paraprakisht e kanë braktisur sallën për kontributin e dhënë në mbledhjen e Kuvendit, i shpalli të myllura punimet e kësaj seance.

Procesmbajtës

Skënder Behramaj



Kryesuesi

Fadil Gashi

